



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY



REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA E KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY

Nr Prot
03-03/3925/18

Date
09-11-2018

PRISHTINE

DATE/A:	09.11.2018
REFERENC-Ë:	AKK- DPKPP /03-03-3772/18
PËR/ZA/TO:	z. Selami BERISHA, Menaxher i Zyrës së Prokurim, Ministria e Zhvillimit Ekonomik
CC:	z. Nazmi ZENELAJ, Sekretar i Përgjithshëm ne Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
PËRMES/PREKO/THROUGH:	z. Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
NGA/OD/FROM:	Afrim ATASHI, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion me lidhur me Tenderin titull: "Servisimi i automjetit Mercedes"

I nderuari z. Berisha,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, nenit 2 par.3 dhe të nenit 10 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores nr. 01/2017, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull: "Servisimi i automjetit Mercedes", me numër të prokurimit: 213/18/8179/221, dhe me nr. të brendshëm: 213/18/010/221, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me tenderin: "Servisimi i automjetit Mercedes", me numër të prokurimit: 213/18/8179/221, dhe me nr. të brendshëm: 213/18/010/221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr.04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr.04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsyetimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 01 nëntor 2018, ka nxjerrë vendim me numër protokoli: *AKK-03-03-3772/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull: "Servisimi i automjetit Mercedes", me numër të prokurimit: 213/18/8179/221, dhe me nr. të brendshëm: 213/18/010/221, i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Ministria e Zhvillimit Ekonomik.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga Sistemi Elektronik i Prokurimit ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, ku ka konstatuar se autoriteti kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurën e hapur, kontratë publike kornizë 36 muaj, të llojit shërbime, me vlerë të mesme të parashikuar prej 75,000.00 €.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma *E-Prokurimi* ka vërejtur se në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, në nenin III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional, autoriteti kontraktues ka kërkuara që *operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka realizuar së paku 3 kontrata për shërbime të ngjashme në tri vitet e shkuara që nga data e publikimit të njoftimit për kontratë, në vlerë se bashku në tri vitet, prej jo më pak se 100,000.00€*. Kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndeshë me nenin 69 Ligjit në fuqi për Prokurimi Publik.

Sipas Legjislacioni në fuqi për Prokurim Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 2.1 parashihet "Për të vërtetuar aftësitë teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, autoriteti kontraktues mund të kërkojë listën me të cilën specifikohen të gjitha furnizimet kryesore të rëndësishme të operatorit ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar produktet e furnizuara, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit; (i) kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij livrimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i livrimit të tillë.

Autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të bëjë kufizimin e numrit të referencave në vlerën e caktuar. E rëndësishme për Autoritetin kontraktues është që ta vërtetoj se operatorët ekonomik përmbushin vlerën minimale e cila është kërkuar nga ana e Autoritetit kontraktues pavarësisht numrit të kontratave. E jo si në rastin konkret ku është kërkuar numri i kontratave në vlerë të caktuar.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë operatorët ekonomik të cilët mund të ofrojnë shërbime të ngjashme, andaj, autoriteti kontraktues duhet të këtë kujdes që të caktoj kërkesa minimale të kualifikimit.

Agjenci kundër Korrupsion, konsideron se veprimet e autoritetit kontraktues bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo-diskriminimi, nenin 27 Dosja e tenderit, si dhe nenin 69 Aftësitë teknike dhe profesionale të Ligjit për Prokurim Publik Nr.04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe nenin 26.8 të Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkeljet e tilla nuk duhet lejuar ne aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsion rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar te gjithë operatorët ekonomik të cilët e kanë tërhequr dosjen e tenderit.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

